



REPUBLIKA E SHQIPERISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE

Nr. 1118/1 Prot

Tiranë, më 11/11/2015

**Lënda:** Jepet mendim mbi projektligjin “Për masat shtesë të sigurisë publike”

**Drejtuar:** Z. Saimir TAHIRI

**MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME**

**Tiranë**

I nderuar z. Ministër,

Projektligji “Për masat shtesë të sigurisë publike” i dërguar për mendim, duhet të vlerësohet në raport me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, njëkohësisht edhe në garantim të një të drejte themelore të njeriut të sanksionuar në nenin 35 të Kushtetutës së Shqipërisë.

Respektimi i kësaj të drejte, gjen zbatim edhe në dokumentet integruese të vendit tonë, e reflektuar kjo në ligjin nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre Anëtare”, ku nga neni 79 i tij buron parashikimi për zhvillimin e kuadrit ligjor në lidhje me mbrojtjen e privatësisë, krijimin e autoritetit mbikëqyrës për mbrojtjen dhe ruajtjen e privatësisë, etj, si edhe në progres raportet e përvitshme të Komisionit European.

Projektligji, në këndvështrimin tonë, nuk është hartuar konform detyrimeve që burojnë nga vlerësimet e mësipërme, njëkohësisht edhe me dispozitat e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Projektligji krijon mundësinë që përpunimi i të dhënave personale i cili do të kryhet nga një prej sistemeve më të rëndësishëm, atë të video survejimit (CCTV), të monitorohet, vlerësojë aspektet e sigurisë, ndikimin e riskut, vendosjen e kamerave, etj, nga Policia e Shtetit, kur një gjë e tillë është kompetencë ligjore vetëm e Autoritetit të pavarur të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP).

Projektligji nuk konsideron se të gjithë palët e përfshira në këtë akt, në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale janë “Kontrollues”. Si të tillë ata zgjedhin në mënyrë të pavarur mjetin dhe mënyrat me të cilat përpunojnë të dhënat personale. Për rrjedhojë, të gjithë subjektet në këtë cilësi detyrohen të zbatojnë legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Të drejtat dhe detyrimet janë të ndërsjella dhe ato zbatohen sipas përkatësisë, në mënyrë proporcionale, gjithnjë pa u tejkaluar (neni 5 dhe 6 i ligjit nr. 9887/2008).

Në nenin 27 të ligjit nr. 9887/2008 parashikohet:

### **Masat për sigurinë e të dhënave personale**

*“2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret të tjera.*

*5. Niveli i sigurisë duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit të të dhënave personale. Rregulla të hollësishme për sigurimin e të dhënave përcaktohen me vendim të komisionerit.*

*6. Procedurat e administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre përcaktohen me vendim të komisionerit”.*

Ndryshe nga sa parashikon ky nen, neni 15 i projektligjit e zgjeron kompetencën edhe për Ministrin e Punëve të Brendshme.

Projektligji synon të shtojë masa të tjera sigurie, kur në relacionin shpjegues nuk del qartë se përse masat e deritanishme nuk kanë sjellë rezultate dhe përse pikërisht përdorimi i masave shtesë do të luajë rol të rëndësishëm në ruajtjen e sigurisë publike.

Në mënyrë të vazhdueshme ekspertët ndërkombëtarë por edhe akte të hartuara prej tyre japin shpjegime të detajuara mbi masat që duhen marrë në rast përdorimi të CCTV, përdorimin e këtij mjete si një mënyrë e padëshiruar por e gjetur si e fundit për të arritur qëllime të caktuara.

Në realitet, Policia e Shtetit, në cilësinë e kontrolluesit, ka të gjitha kompetencat që të aksesojë xhirimet që i nevojiten, por brenda qëllimit të përpunimit, jo më tepër. Kjo kompetencë, por gjithnjë pa u tejkaluar, i njihet Policisë së Shtetit drejtpërdrejtë nga ligji organik i saj si dhe nga Kodi i Procedurës Penale.

Nëpërmjet këtij projektligji, aksesit (*sipas nenit 14*) bëhet i pakufizuar. Ky parashikim është në shkelje të hapur të parashikimeve të bëra në nenin 5 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

*Sipas nenit 4/1/a* vendosja e kamerave bëhet e detyrueshme edhe në ambientet e punës. Një gjë e tillë bie në kundërshtim me **pikën 10/2 të** Udhëzimit nr. 11/2011 “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, të Komisionerit i cili ndalon në mënyrë kategorike survejimin e punonjësve, pasi është në tejkalim të qëllimit. Në këtë pikë parashikohet shprehimisht “*Kamera e vëzhgimit nuk mund të përdoret për mbikëqyrjen e një punonjësi në vendin e punës...*”.

Policia është përgjegjëse vetëm për survejimin e ambienteve publike me qëllim ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike. Nëpërmjet këtij projektligji bëhet i detyrueshëm survejimi edhe i ambienteve private duke e lënë tërësisht në gjykimin e policisë se kush dhe ku duhet instaluar kamera. Kjo krijon hapsirë për abuzime dhe cënim të rëndë të privatësisë si një e drejtë themelore kushtetuese.

Sistemi i video survejimit nuk duhet të ndërhyjë në jetën private të individëve. Përpunimi i të dhënave me anë të një sistemi video-survejimi mund të lejohet vetëm nëse qëllimi për të cilin është instaluar ky sistem nuk mund të arrihet në një mënyrë tjetër. Ky është edhe qëndrimi i Opinionit 4/2004 të Grupit të Punës Neni 29 “ Mbi përpunimin e të dhënave nëpërmjet përdorimit të video survejimit”, të Bashkimit Europian. Specifika dhe sensitiviteti i kësaj mënyre përpunimi të të dhënave personale, është theksuar drejtpërdrejtë edhe në Direktivën 95/46/EC (ligji nr. 9887/2008, është hartuar tërësisht në frymën e kësaj direktive) ku parashikohet:

*Direktiva aplikohet duke patur parasysh rëndësinë e zhvillimeve aktuale në kuadrin e shoqërisë së informacionit, të teknikave që përdoren për të kapur, transmetuar, manipuluar, regjistruar, ruajtur apo komunikuar të dhënat në formë tingulli apo imazhesh që lidhen me të gjithë personat fizikë... (Parag.14)*

*Duke qenë se parimet e mbrojtjes duhet të gjejnë zbatim tek çdo informacion që lidhet me një person të identifikuar apo të identifikueshëm; se për të përcaktuar nëse një person është i identifikueshëm, duhet të merret parasysh tërësia e mjeteve që mund të përdoren brenda arsyes ose nga kontrolluesi ose nga ndonjë person tjetër për ta identifikuar personin në fjalë (paragraph. 26);*

Përveç sa më sipër, nga praktika ndërkombëtare shumë pak shtete kanë një ligj të veçantë për monitorimin nëpërmjet sistemit të CCTV të ambienteve të tjera, përveç atyre publike, nga ana e Policisë së Shtetit.

**Neni 6** i projektligjit i jep pushtet të pakufizuar Policisë për të vlerësuar instalimin e sistemit CCTV praktikisht kudo, edhe në banesa, nëse përbën “burim rreziku të shtuar”.

*Sipas nenit 6*, rrethi për subjektet që janë të detyruara të marrin masa shtesë sigurie zgjerohet edhe më tej, duke lënë thjesht në vlerësim të Policisë së Shtetit, pasi nuk ka asnjë dallim që mund të kufizojë apo përcaktojë llojin dhe masën e rrezikut.

Analiza e vlerësimit të rrezikut *sipas nenit 7* të projektligjit çon në vlerësimin e masave shtesë të sigurisë që një subjekt duhet të marrë. Për rrjedhojë përcaktimi i masave shtesë të sigurisë shkon paralelisht edhe me përpunimin e më shumë të dhënave dhe pa dyshim cënimi i privatësisë është edhe më evident, çka kërkon analizën e vlerësimit të riskut mbi të dhënat.

Analiza e vlerësimit të riskut është një prej detyrimeve që e mbart çdo kontrollues, bazuar në Udhëzimin nr. 21/2012 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha” të Komisionerit.

Kërkesa për përcaktimin e masave të sigurisë nga çdo kontrollues si dhe kompetenca për të mbikëqyrur, kontrolluar, ushtruar hetime dhe vendosur sanksione në rast të konstatimit të shkeljeve nga autoriteti i Komisionerit, është transpozuar në ligjin nr. 9887/2008 nga Direktiva 95/46/CE.

*Neni 8* i projektligjit shkel hapur privatësinë dhe të drejtën e komunitetit për t’u filmuar apo regjistruar dhe bie në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3/2010 “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera” të Komisionerit, pasi ky i fundit bën të detyrueshëm marrjen e pëlqimit me shkrim të 75% të banorëve të pallatit, referuar kjo edhe praktikave ndërkombëtare.

Udhëzimi nr. 12/2011 “Për kontrollin dhe identitetin në hyrje të ndërtesave”, i Komisionerit në një parashikim të tij ndalon përpunimin e të dhënave të vizitorëve me këtë mjet nëse një ndërtesë ose një zonë është e hapur për publikun. Gjithashtu udhëzimi i Komisionerit kërkon që pronari ose administratori duhet të mbajë lidhje dhe të njoftojë Komisionerin për çdo përpunim për qëllime të mbrojtjes së pronës ose të administrimit të ndërtesës dhe të sigurisë.

Udhëzimi nr. 3/2010, i Komisionerit kërkon përdorimin e CCTV si mjet dhe mënyrë e fundit. Gjithashtu, ky udhëzim kërkon të informojë subjektet dhe ndërkohë kërkon që këto të fundit të ushtrjnë të drejtat e tyre dhe në rast cënimi të privatësisë dhe ushtrimit të të drejtave, t’i drejtohen Autoritetit të Komisionerit.

*Përcaktimi në nenin 10* i lëshimit të “Vërtetimit të sigurisë”, organi dhe kriteret mbi të cilat ai jepet, konkuron kompetencat e Autoritetit të Komisionerit.

*Edhe në nenin 14* të projektligjit me titull “Detyrimi për dhënie informacioni”, dhënia e informacionit për Policinë do të duhet të ketë të përcaktuar qëllimin e kërkimit dhe mos tejkalimin e tij, pra do të aksesojë vetëm në të dhënat që nevojiten për një rast konkret.

*Neni 16 dhe 17* i projektligjit konkuron kompetencat ligjore të Autoritetit të Komisionerit, pasi inspektimet për fushën që i përket mbrojtjes së të dhënave personale janë kompetencë e tij.

Në konkluzion të vlerësimeve të mësipërme, projektligji “Për masat shtesë të sigurisë publike”, nuk vlerësohet i hartuar konform dispozitave ligjore që garantojnë të drejtën kushtetuese të mbrojtjes së të dhënave personale dhe të privatësisë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

